AKTUALITET

Aksion në vend! RENEA dhe FNSH zbresin në 5 qytetet problematike në vend, kontrollohen bizneset e të fortëve e makinat luksoze, kapet Edison Begaj, Talo Çela në 'shënjestrën' e bluve, ç'kërkohet në lokalin e Dervishajt

Në Vlorë është vënë në pranga Edison Begaj, 38-vjeçari që i shpëtoi një atentati mbrëmjen e 29 majit. Në Elbasan, policia ka rrethuar zonën e Bradasheshit dhe mësohet se është nisur në aksion për kapjen e të shumëkërkuarit Talo Çela. Në Durrës, forcat RENEA janë fokusuar në baret e lokalet që mendohet se frekuentohen nga persona problematikë që lëvizin me armë zjarri.

Edison Begaj dhe foto ilustruese

14 Qershor, 2021 20:26

SHQIPËRI– Vlora, Elbasani, Lushnja, Fieri e Durrësi kane qenë pesë qytetet që janë kontrolluar nga efektivët e forcave RENEA dhe të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë. Dosja.al ka mësuar se uniformat e shtetit kanë zbritur në terren, në pesë qytetet më problematike, përsa u përket aktiviteteve kriminale në vend dhe kanë ushtruar kontrolle të lokale, biznese e makina të ndryshme.

Në Vlorë është vënë në pranga Edison Begaj, 38-vjeçari që i shpëtoi një atentati mbrëmjen e 29 majit. Begaj u kap në një nga lokalet më të frekuentuara në zonën e Lungomares në Vlorë, pasi ishte i pajisur me armë zjarri. Arrestimi i tij u pa nga të gjithë klientët në bar.

Në Elbasan, policia ka rrethuar zonën e Bradasheshit dhe mësohet se është nisur në aksion për kapjen e të shumëkërkuarit Talo Çela, i cili u ka shpëtuar edhe katër operacioneve të mëparshme të organizuara nga RENEA. Këtë herë, për të mos u dekonspiruar, nuk është njoftuar asnjë nga efektivët e komisariatit të Elbasanit.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, **Dosja.al**

Në Durrës, forcat RENEA janë fokusuar në baret e lokalet që mendohet se frekuentohen nga persona problematikë që lëvizin me armë zjarri. Një prej bizneseve ku mësynë efektivët, është edhe ai i kunatit të Lulzim Berishës, Plarent Dervishaj. Ndërkohë që ky i fundit ndodhet në Dubai, RENEA i kontrolloi biznesin. Nën 'sitën' e kontrolleve janë vënë edhe disa lokale të tjera me mjaft emër në qytetin e Durrësit.

Gjithashtu bëhet me dije se në komisariat kanë përfunduar dhjetëra persona, emrat e të cilëve nuk dihen ende, dhe as shkaqet e prangosjes nuk janë bërë me dije.

(F.m/Dosja.al)

23:06 - RENEA në Durrës, kontrollohen lokalet e të 'PROBLEMATIKËVE' të zonës, me tyre dhe i Plarent Dervishit...pronari, në Dubai

Foto Ilustruese

Forcat RENEA që kanë nisur një aksion me kontrolle mbrëmjen e sotme kanë zbarkuar dhe në lokalet e disa prej personave me precedent penalë në qytetin e Durrësit. Panorama shkruan se një prej lokaleve që është kontrolluar sot, është ai i Plarent Dervishajt, ndërkohë që ky i fundit ndodhet në Dubai. Efektivët kanë futur në sitën e kontrollit disa lokale të njohura në qytetin e Durrësit, që mendohet se frekuentohen nga personazhe të njohura të botës së krimit.

21:51 - 'Zbrazet' çdo makinë luksoze! Forcat RENEA vihen në kërkim të Talo Çelës, rrethojnë zonën ku ka shtëpinë



Talo Çela

Forcat RENEA janë vënë në kërkim të të shumëkërkuarit Talo Çela që akuzohet për një sërë veprash penale të rënda kriminale. Mësohet se në kuadër të aksionit që është shtrirë mbrëmjen e sotme në pesë qytetet e vendit, RENEA ka 'zbarkuar' dhe në Elbasan. Mësohet se uniformat e shtetit kanë rrethuar dhe zonën e Bradasheshit, aty ku dhe Çela ka shtëpinë, të cilës iu vendos dhe një sasi tritoli në muajin nëntor të vitit të kaluar. Çdo makinë luksoze që kalon, 'zbrazet' dhe kontrollohet në mënyrë të imtësishme. Talo Çela u ka shpëtuar katër operacioneve nga forcat RENEA, i fundit, në muajin gusht të vitit të shkuar.

21:38 - Jo vetëm në Vlorë! RENEA shtrin aksionin në pesë qytetet e Shqipërisë

Foto Ilustruese

Forcat RENEA kanë shtrirë aksionin e tyre në pesë qytetet të Shqipërisë. Mësohet se përveç Vlorës, RENEA ka 'zbarkuar' në mënyrë të befasishme në Elbasan, Lushnje, Fier e Durrës. Në të pestë qytetet po ushtron kontrolle në lokale e zona ku mendohet se qëndrojnë persona të rrezikshëm që qarkullojnë me armë zjarri, apo të shpallurit në kërkim. Deri më tani mësohet se janë arrestuar dhjetë persona. Në Vlorë u kap subjekti i OFL-së, Edison Begaj, i cili vetëm apk ditë më parë i shpëtoi një atentati, ngjarje që ndodhi në sy të fëmijëve të tij. Begaj u kap në një lokal, me armë zjarri.

21:22 - Vëzhgohej prej ditësh! Dalin PAMJET, si u kap Edison Begaj me armë në brez në mes të lokalit, arrestimi u pa nga të gjithë klientët

Edison Begaj u vu në pranga sot dhe arrestimi i tij u dëshmua nga klientë të shumë që ndodheshin në lokal në ato momente. Balkanweb ka publikuar pamjet nga momenti i arrestimit të Begajt, 38-vjeçarit që sot u kap me armë, por vetëm mbrëmjen e 29 majit, ra pre e një atentati. Mësohet se Begaj vëzhgohej prej disa ditësh nga efektivët, të cilët ishin pozicionuar në Vlorë në Lungomare dhe kishin në fokus personat problematikë.

20:36 - Iu bë atentat në sy të fëmijëve, arrestohet Edison Begaj në Vlorë, subjekt i OFL-së

Edison Begaj

Edison Begaj, 38-vjeçari që i shpëtoi atentatit që iu bë në sy të fëmijëve më 29 maj, është vënë në pranga. Mësohet se Begaj është arr***estuar në kuadër të një operacioni*** 'blic' të zhvilluar nga forcat RENEA mbrëmjen e sotme në Vlorë. Mësohet se Begaj është prangosur pasi është kapur me armë zjarri. Begaj ra pre e një atentati mbrëmjen e 29 majit. Një person i veshur me uniformë policie i zuri pritë ndërkohë që ai po udhëtonte me makinë më fëmijët e tij. Sapo Begajt zbriti nga mjeti u përball me plumbat, skenë që u pa dhe nga fëmijët e tij. Për autorët e atentatit nuk dihet ende asgjë, dhe deri më tani është gjetur vetëm makina e djegur. Shkaqet mendohet të kenë qenë pazaret e drogës.

ETIKETA: #arrestohet edison begaj #operacion ne vlore #RENEA ne Vlore

0
SHARES

Previous article
Përfundon takimi Erdogan-Biden, homologët nuk japin asnjë detaj nga takimi, presidenti i SHBA: Ishte një takim shumë i mirë

Next article
Mbillnin hashash në serë/ Policia greke shpërbën bandën, në pranga 24 personave, mes tyre edhe shqiptarë

Shto Koment

Emri Juaj* E-Mail*

Komenti Juaj*

Dërgo

POSTIME TË NGJASHME



Aktualitet

RENEA në Durrës, kontrollohen lokalet e të 'PROBLEMATIKËVE' të zonës, me tyre...



Aktualitet

Në Shqipëri mbërrijnë 11 mijë e 7 qind vaksina Pfizer



Aktualitet

Aksident në Durrës/ Makina tip 'Ford' përplaset me automjetin e parkuar, një...



Aktualitet

'Zbrazet' çdo makinë luksoze! Forcat RENEA vihen në kërkim të Talo Çelës, rrethojnë zonën...

STAY CONNECTED

Facebook LIKE
Twitter FOLLOW
Instagram FOLLOW
Youtube SUBSCRIBE

LAJMET E FUNDIT



14 Qershor, 2021 23:08

"Është ngatërruar person", 18-vjeçari arrestohet gabimisht për vjedhje biçiklete, lihet në burg prej 10-ditësh



14 Qershor, 2021 23:07

Drithërima dhe emocione, Suedia bllokon mes infarktit Spanjën

14 Qershor, 2021 23:05

RENEA në Durrës, kontrollohen lokalet e të 'PROBLEMATIKËVE' të zonës, me tyre dhe i Plarent Dervishit...pronari, në Dubai



14 Qershor, 2021 23:00

Në Shqipëri mbërrijnë 11 mijë e 7 qind vaksina Pfizer

Aleanca për Media Etike
Artikull joetik?
raporto këtu

dosja.al
ME RITMIN E NGJARJES

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

info@dosja.al +355 682676444

Stafi

Drejtor : Enton Abilekaj
Kryeredaktor : Fjola Graçi

Gazetarë :
Kejsi Muça
Dezdemona Kolaveri
Izmir Akulli
Daniela Andrellari
Eda Kola
Florida Mingla
Alberta Boseta
Kleida Muka
Orgeta Likaj

© 2021 Dosja. Të gjitha të drejtat e rezervuara.